



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS KLINË

Numri i lëndës: 2022:107974

Datë: 31.05.2024

Numri i dokumentit: 05761670

C.nr. 508/23

Gjykata Themelore Pejë-Dega në Klinë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtaren Fllanza Hashani, me bashkëpunëtore Albulena Morina-Lulaj, në çështjen juridike-kontestimore të paditësit: M. K, nga fshati , Komuna Klinë, të cilin e përfaqëson e autorizuar Leonora Dervishaj-Pacolli, kundër të paditurës Komuna Klinë-D, Klinë të cilën e përfaqëson përfaqësuesi Bledar Berisha, me bazë juridike: anulim vendimi, jashtë seancës gjyqësore, me datë 24.05.2024 mori këtë:

A K T V E N D I M

I.KONSIDEROHET SE ËSHTË TERHEQUR, padia e paditësit M. K, nga fshati , Komuna Klinë, me numër të lëndës 508/23, e datës 27.05.2022, kundër të paditurës Komuna Klinë-Drejtoria për Arsim, Klinë, me bazë juridike: anulim vendimi 04 nr. 111-14079-22 të datës 05.05.2022.

II. Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi M K, nga fshati , Komuna Klinë, përmes të autorizuarës së tij me datë 27.05.2022, ka parashtruar padi kundër të paditurës Komuna e Klinës, me bazë juridike: anulim vendimi 04 nr. 111-14079-22 të datës 05.05.2022.

Gjykata në këtë çështje juridike kontestimore ka caktuar dhe mbajtur shqyrtimin përgatitor me datë 23.05.2024, me fillim në ora 09:10, në të cilën nuk ka prezantuar e autorizuar e paditësit, e cila ka qenë e ftuar në mënyrë të rregullt nga gjykata, që është vërtetuar nga fletë kthesa në shkresat e lëndës, nga e cila rezulton se e autorizuar e ka pranuar ftesën me datë 22.04.2024, por e cila mungesën nuk e ka arsyetuar.

Sipas nenit 409 par. 1 të Ligjit Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore (LPK), përcaktohet se ‘ *Në qoftë se në seancën përgatitore nuk vjen pala paditëse edhe pse është thirrur rregullisht, padia konsiderohet e tërhequr, përveç kur i padituri kërkon që seanca të mbahet në mungesë të paditësit*’. Prandaj në referim të kësaj dispozite ligjore dhe nga arsyet e lartcekura rezulton se plotësohen të gjitha kushtet ligjore që padia në këtë çështje kontestimore, të konsiderohet e tërhequr.

Andaj, gjykata duke u mbështetur në dispozitat e nenit 409 par. 1 lidhur me nenin 387 par. 1 pika c dhe nenit 450 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË-DEGA NË KLINË-

Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil

C.nr.508/23, data 24.05.2024.

Gj y q t a r j a:

Fllanza Hashani

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktvendimi, nëpërmes kësaj Gjykate për Gjykatën e Apelit.